

Reforma Ivanaj (1932-1936): Përpyjekja për Nacionalizimin e Arsimit në Shqipëri në Kushtet e Krizës së Marrëdhënieve Italo-Shqiptare

Received: 5 May 2025 / Accepted: 10 July 2025 / Published: 16 July 2025

© 2025 Anelmo Spahija

Doi: <https://doi.org/10.5281/zenodo.15974075>

Abstract

One of the important elements of the consolidation of the nation-state in modern societies of XIX-XX centuries was the nationalization of education, in terms of not only the use of education in the function of the national idea and consciousness, but also its use in the function and service of official policies imposed and followed by the nation-state. In Albania, this process has its beginnings, of course with the beginnings of the independent Albanian state, but the political crises that the country went through until after the First World War and the final securing of international recognition and the foreign influences of neighboring countries in the cultural and educational fields (especially Italian and Greek schools) delayed the realization of this process, which had previously been realized in many European countries during the first phases of their consolidation. The nationalization of education was first undertaken in Albania in the years 1932-1936, being directly linked, firstly, to the crisis of Albanian-Italian relations, to the efforts of Ahmet Zogu to weaken the influence of fascist Italy in Albania and, secondly, to the efforts of patriotic and nationalist elements in the country, represented by the Minister of Education, Mirash Ivanaj, under whose leadership the reform went beyond the purely anti-Italian character, being accompanied by the nationalization of all foreign schools in the country and their placement under a common program and regulations of a national character. This study examines the political causes and the inability of the Albanian state to pursue such a policy in the long term, mainly related to the international factor, with the increase in political, economic and military pressure from fascist Italy.

¹ Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti i Historisë. Email: (anelmo.spahija@unishk.edu.al)

Hyrje

Depërtimi i kapitalit italian në Shqipëri dhe rritja e influencës politike në vend, u shoqërua edhe me përpjekjet për të ndikuar në fushën e arsimit dhe të kulturës. Që në fund të shek XIX fillojnë të ngrihen shkollat e para italiane në Shkodër e Vlorë. Në fillim të shek.XX, pati një rritje të mëtejshme të rrjetit shkollor italian. Në vitin 1909 në Shkodër kishte 6 institucione arsimore italiane. Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, pas depërtimit ushtarak në Shqipëri, numri i shkollave arriti në 133². Pasi organizoi administratën arsimore me drejtues e inspektorë italianë, qeveria italiane nisi në Shqipëri kontigjente mësuesish ushtarakë italianë.

Hovin më të madh, përhapja e shkollave italiane e mori pas vitit 1925. Politika e dyerve të hapura e ndjekur nga Ahmet Zogu reflektua edhe në fushën e arsimit dhe kulturës. Në shkurt 1928 doli vendimi i qeverisë që sanksionoi kufizimin e gjimnazeve vetën në tre të tillë për të gjithë Shqipërinë dhe parashikoi ngritjen në vend të tyre të shkollave të ulëta profesionale që do të çelëshin nga Italia. Në qershor 1928 u arrit marrëveshja për ngritjen e shkollave profesionale me personel dhe bazë materiale italiane³. Ndërhyrja italiane u zgjerua edhe në arsimin fillor. U mbyllën 59 shkolla fillore fshati dhe në vend të tyre u hapën 11 shkolla fillore-konvikt italiane. Shkolla të tilla u ngritën në Tiranë, Shkodër (2 shkolla që administroheshin nga kleri katolik), Vlorë dhe Durrës⁴. Për të siguruar një tërheqje sa më të madhe të rinisë shqiptare në rrjetën e ndikimit italia, iu kushtua rëndësi ndërhyrjes në aktivitetet jashtëshkollore. Në çdo prefekturë kishte nga një officer italian me titullin e kryeinstruktorit të edukatës fizike, ndërsa në Ministrinë e Arsimit u vendos oficeri Agustinuçi, me cilësinë e inspektorit qendror të edukatës fizike. Vitet 1929-1931 shënojnë një rritje të interesit të qeverisë italiane për zgjerimin dhe mënyrën se si duhet të funksiononin shkollat italiane në Shqipëri. Pranë Ministrisë së Arsimit u krijua një seksion i ri për shkollat profesionale italiane, në krye të të cilit u caktua Luraski. Qëllimi i emërimit të tij ishte përmirësimi i funksionimit dhe adaptimi i sistemit arsimor shqiptar në favor të depërtimit të kulturës, gjuhës, dhe të propagandës fashiste në Shqipëri. Ai ndërmerte vizita e turne në vendet ku do të çelëshin shkollat e reja. Gjithashtu mund të hartonte programet për administrimin e shkollave në të gjithë Shqipërinë, pa pasur nevojë të konsultohet me Ministrinë e Arsimit.

Si funksiononin shkollat italiane në Shqipëri? Cili ishte qëllimi i hapjes së tyre? Shteti italian, sidomos pas ardhjes në pushtet të Mussolinit investoi në Shqipëri për arsimin me qëllim që, duke përhapur kulturën, gjuhën italiane dhe propagandën fashiste në vend, të krijohej një

² Iljaz Gogaj, *Ndërhyrja arsimore italiane në Shqipëri dhe qëndresa kundër saj*, 8 Nëntori, Tiranë, 1980, 8-15

³ Po aty, 32

⁴ Po aty, 33

mbështetje sa më e gjerë ndaj Italisë dhe t'i hapet rruga më tej depërtimit ekonomik e politik në Shqipëri. Investimi në arsim përqëndrohej në ngritjen e shkollave profesionale, të mesme dhe fillore. Çelja e shkollave profesionale filloi në vitin 1929, me ngritjen e shkollës së parë profesionale në Gjirokastrë, e më pas në Berat, Shkodër e Korçë. Drejtimi kryesor i këtre shkollave ishte industrial-artizanal, ku përgatiteshin mekanikë(axhustatorë, elektrikistë, kovaçë) dhe marangozë. *“Të përgatiten artizanë dhe teknikë për nevojat imediate të vendit, krejtësisht me mjetet e kulturës italiane, duke rritur përhapjen e gjuhës dhe të vetëdijes së qytetërimit italian”*⁵ ishte objektivi kryesor i Ministrisë së Punëve të Jashtme italiane. Përveç shkollave profesionale, shteti italian investoi edhe në ngritjen e shkollave fillore. Shkolla të tilla u ngritën e Durrës, Tiranë, Vlorë dhe në Shkodër. Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit në favor të interesave italiane luajti edhe kleri katolik. Shkolla mikste saleziane, shkolla femërore stigmatine në Shkodër, më pas shkolla fillore e ngritur nga murgeshat në Durrës, shkolla fillore e ngritur nga jezuitët në Tiranë etj, patën mbështetjen e plotë të Legatës Italiane, e cila do të ndërhynte tek Ministria e Arsimit për njohjen e tyre. Edhe në shkollat e mesme shtetërore, influenca italiane u bë aktive, përmes punësimit të mjaft mësuesve italianë, për mësimin e gjuhës dhe kulturës italiane.

Kriza në marrëdhëniet shqiptaro-italiane dhe rritja e frymës anti-italiane

Marrëdhëniet italo-shqiptare shkuan drejt ashpërsimit gjithnjë e më të madh pas refuzimit të qeverisë shqiptare për të rinovuar Traktatin e Parë të Tiranës, në nëntor 1931. Ky vendim i Ahmet Zogut dhe qeverisë shqiptare lidhej me rritjen e vazhdueshme të influencës së Italisë fashiste pothuajse në të gjitha sektorët e shtetit dhe shoqërisë shqiptare. Benito Musolini synonte të shfrytëzonte situatën e rëndë ekonomike të vendit, e cila vështirësohej edhe më tej në kushtet e krizës ekonomike botërore, që kishte filluar në vitin 1929. Kushtet e kredisë së SVEA-s për rimëkëmbjen e ekonomike të vendit kishin qenë të rënda, duke parashikuar vndosjen e “specialistëve italianë” në ministritë shqiptare dhe në sektorë të ushtrisë⁶. Kjo politikë imperialiste e Italisë fashiste që rrezikonte seriozisht sovranitetin dhe pavarësinë e vendit, përpjekjet e mbretit e qeverisë shqiptare për të shmangur një skenar të tillë nxitën frymën anti-italiane në vend.

Fryma anti-italiane që filloi të shfaqej në Shqipëri në fillim të viteve 30', u shfaq edhe në rritjen e protestës ndaj dominimit italian në fushën e arsimit. Zërat e protestës vinin kryesisht nga intelektualë të klasës së mesme. Hobsbaum në studimet e tij mbi nacionalizmin gjuhësor, vë në dukje se janë pikërisht klasat e mesme ato që ndihen drejtpërdrejt të rrezikuara nga

⁵ Iljaz Gogaj, *Ndërhyrja arsimore italiane në Shqipëri dhe qëndresa kundër saj*, 8 Nëntori, Tiranë, 1980, 69

⁶ Paskal Milo, *Politika e jashme e Shqipërisë I (1912-1939)*, Toena, Tiranë, 2013, 798-801

depërtimi i kulturave dhe gjuhëve të huaja në një vend të caktuar. Ai përmend si shembull rastin e nacionalizmit flamand në Balgjikën Veriore, të nxitur kryesisht nga klasat e mesme flamande: “*Vetë fakti që, për të njëjtin post, një flamand patjetër duhej të ishte dygjuhësh, ndërsa ai që e kishte frëngjishten gjuhë amtare kishte nevojë vetëm për një njohje të përciptë të gjuhës tjetër... vinte në dukje inferioritetin e gjuhës më të dobët.*”⁷ Përhapja e shkollës italiane në Shqipëri dhe roli gjithnjë e më i rëndësishëm që po merrte gjuha italiane në të gjitha shkallët e arsimit (tashmë kishte filluar një dyndje e mësuesve italianë në Shqipëri, me qëllimin që t’i transmetohej sa më mirë nxënësve “*entuziazmi i gjallë dhe shpirti i italianizimit*”⁸, gjë që nuk mund të realizohet nga mësues joitalian), kërcënonte pozitat modeste të klasës së mesme shqiptare, e cila sapo kishte filluar të formohej. Prandaj në qytetet kryesore të Shqipërisë filloi një lëvizje e gjerë kundër arsimit italian. Filluan të shfaqeshin artikuj ku evidentoheshin rreziqet e arsimit në gjuhë të huaj. “*Nji arsim filluer në gjuhë të huej asht si me helmatisun ndërgegjen kombëtare në djep, asht nji thikë me dy presa në shpirtin, në zemrën e kombit*”, shkuhej në gazetën “Shekulli i ri”, ndërkohë që në “Gazeta e Re” botohej artikulli me titull “*Kulturë, por kombëtare*”⁹. Gjithnjë e më tepër, mësues e punonjës të arsimit kërkonin që Ministria e Arsimit të nxiste futjen e mësimit të shqipes në shkollat italiane në vend dhe punësimin në to edhe të mësuesve shqiptarë. Inspektorët e arsimit Kol Koçi e Dhimitër Gjerga vinin në dukje krijimin në qytetin e Shkodrës të një rryme të fortë anti-italiane. Për krijimin e kësaj situate në Shkodër dëshmonin edhe raportet e konsullit italian Meloni, i cili informonte legatën në Tiranë mbi disa mësues shkodranë që zhvillonin një “*fushatë denigruese në dëmin tonë.*”¹⁰ Një rrymë e tillë filloi të ngjallej edhe në Vlorë, ku drejtori i shkollës shqipe i këkonte Ministrisë së Arsimit që të merreshin masa ndaj konkurrencës që shkolla italiane i bënte shkollës shqipe. Ai vinte në dukje se si shkolla italiane tërhiqte gjithnjë e më shumë nxënës shqiptar, dhe kjo ishte në dëm të interesit kombëtar. Gjithashtu mësues të tjerë shqiptarë dërgonin nota proteste mbi rolin propagandistik që luante shkolla italiane e Vlorës. Pakënaqësi të shumta u lindën ndaj italianizimit të shkollës tregtare të Vlorës. Edhe pse ishte shkollë shtetërore, me ndërhyrjen e Legatës italiane u arrit që gjysma e mësuesve të ishin italian, dhe që të zhvilloheshin një numër i caktuar lëndësh në italisht. Sipas ministrit të arsimit, Hilë Mosi, këto veprime bëheshin pa miratimin e ministrisë. Pas ardhjes së drejtorit Naun Stralla, i cili pakësoi orët e mësimit të mësuesve italianë, u forcua edhe më tej reagimi anti-italian, aq sa

⁷ Erik Hobsbaum, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780-a*, Toena, Tiranë, 1996, 119

⁸ Iljaz Gogaj, *Ndërhyrja arsimore italiane në Shqipëri dhe qëndresa kundër saj*, 8 Nëntori, Tiranë, 1980, 96

⁹ Gazeta e Re, dt. 8.1.1929, Nr.55, fl. 1

¹⁰ Iljaz Gogaj, *Ndërhyrja arsimore italiane në Shqipëri dhe qëndresa kundër saj*, 8 Nëntori, Tiranë, 1980, 86

konsulli italian vinte në dukje qëndrimin “josimpatik” ndaj profesorëve italianë¹¹. Edhe në Elbasan pati një lëvizje anti-italiane, ku intelektualë të shtresave të mesme nxitën protesta kundër futjes së italishtes si gjuhë të detyrueshme në Shkollën Normale dhe sidomos kundër mësuesit italian Arnaldo Forenzi, që dallohej si propagandues i fashizmit. Që në vitin 1930, në postin e Ministrisë së Arsimit u vendos Hilë Mosi, i cili nuk ngurroi të evidentonte pengesat që i sillnin shkollat italiane përhapjes së arsimit kombëtar dhe shkeljet që ato bënin. Ai akuzonte konsullatën italiane për veprimet e saj në favor të rritjes së personelit italian në shkollat shqiptare, veprime që bëheshin pa u konsultuar me Ministrinë e Arsimit. Qëllimi i tij ishte krijimi i një sistemi arsimor laik dhe nën kontrollin e shtetit. Ai nxiti shtypin vendas që t’i propagandonte edhe më tej këto ide. U dallua revista “Edukata e re”, e drejtuar nga Vasil Vinjau, e cila rivendikonte të drejtën dhe detyrën e edukimit që kishte shteti që kishte shteti. Nga ana tjetër, qarqet klerikale, interesat e të cilëve prekeshin në këtë rast, zhvillonin replikën e tyre kundër Hilë Mosit dhe rrymës anti-italiane tek revista “Hylli i Dritës”.

Dekret Ligji mbi Arsimin

Prandaj, si reagim ndaj përpjekjeve të Musolinit për ta nënshtuar përfundimisht Shqipërinë, sidomos përmes imponimit të bashkimit doganor, por edhe si përgjigje ndaj një rryme të fortë kundër përhapjes së arsimit italian në Shqipëri, Ahmet Zogu dhe qeveria e tij vendosën të vepronin. Me 14 shtator 1932 u botua Dekret Ligji për shkollat e huaja në Shqipëri. Ai u miratua në parlament në prill 1933¹². Sipas tij, qytetarët shqiptar ndaloheshin të dërgonin fëmijët e tyre në shkollat e huaja fillore brenda ose jashtë Shqipërisë. Në rast se ky ligj nuk zbatohej, ata dënoheshin me dy deri në gjashtë muaj burg ose me pagimin e një shume që shkonte nga 500 deri 1000 franga. Ligji i jepte të drejtë parapëlqimi në kandidaturat e nëpunësive qeveritare, atyre studentëve që kishin kryer studimet në Shqipëri. Pra, ata do të kishin përparësi për tu punësuar në administratën shtetërore në krahasim me ata që kishin kryer studimet në shkollat e huaja. Ligji dënonte me dy muaj burg dhe me përjashtim nga çdo nëpunësi në administratë, edhe ata nxënës që pa lejen e Ministrisë së Arsimit vazhdonin të ndiqnin mësimet jashtë shtetit, me bursa të shteteve të huaja. Pavarësisht shpalljes së tij, Dekret Ligji nuk hyri menjëherë në fuqi, pasi më parë duhej të ratifikohej nga parlamenti, dhe së dyti duhet të hartohej një plan për zhvillimin e arsimit kombëtar që do të zëvendësonte rolin që kishin shkollat e huaja, që më shumicën e tyre ishin italiane.

Në dhjetor, Hilë Mosi vdiq. Vendi i tij e zuri Mirash Ivanaj, i cili ishte një mbështës edhe më radikal i reformës. Idetë e tij ai i shpreh në një raport që i paraqet mbretit, dy javë pasi

¹¹ Iljaz Gogaj, *Ndërhyrja arsimore italiane në Shqipëri dhe qëndresa kundër saj*, 8 Nëntori, Tiranë, 1980, 91

¹² Fletorja Zyrtare, 22 prill 1933, Nr 21, 1

kishte marrë postin e ministrit (janar 1933). Në këtë raport parashtrohet si ide qëndrore domosdoshmëria e reformimit të arsimit shqiptar me synim kryesor nacionalizimin dhe laicizimin e tij. Pengesë për këtë qëllim madhor përbënin numri i madh i shkollave të huaja dhe klerikale si gjimnazet e françeskanëve dhe jezuitëve në Shkodër, shkollat e huaja fillore, shkollat profesionale italiane në Shkodër, Korçë, Berat, e Gjirokastrë, shkolla italiane e muzikës në Tiranë, Shkolla e Komunitetit Mysliman në Tiranë etj. Ai i vuri në dukje Zogut edhe faktin që funksionarët italian kishin arritur të infiltroheshin në Ministrinë e Arsimit duke ngritur organe paralele, si dhe veprimet që ata bënin pa arrë pëlqimin e shtetit shqiptar. Në këtë raport, paraqiti edhe propozimet e tij: ndryshimi i nenit 206 të Statutit Themeltar, që lejonte çeljen e shkollave të huaja në Shqipëri, të kufizohej prania e nëpunësve italianë në Ministrinë e Arsimit dhe të vihehin nën kontrollin e ministrisë. Përsa i përket bursave që jepte qeveria italiane për studentët shqiptarë, ato mund të pranoheshin më kusht që studentët të zgjidheshin nga vetë shteti¹³. Pasi mori miratimin e Mbretit për platformën e re që paraqiti, nisi puna për të projektuar atë që ka hyrë në histori me emrin “Reforma Ivanaj”.

Me 11 prill 1933, parlamenti shqiptar miratoi Dekret Ligjin mbi Arsimin, si dhe u ndryshuan nenet 206 dhe 207 të Statutit Themeltar të Mbretërisë: “*Mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptar janë një e drejtë ekskluzive e shtetit. Arsimi fillor është i detyrueshëm dhe jepet falas*”. Gjithashtu u vendos që katër shkollat profesionale italiane të kalonin nga administrimi i drejtorëve italianë, në atë të drejtorëve shqiptarë.¹⁴ Këto shkolla tashmë nuk do të varehin nga seksioni i shkollave profesionale, por nga seksioni i shkollave të mesme pranë Ministrisë së Arsimit. Edhe organizatori italian i këtyre shkollave do të vihej nën kontrollin e Ministrisë së Arsimit. Gjithashtu të gjithë mësuesit italianë duhet të lidhnin kontratë legale me Ministrinë e Arsimit¹⁵. Gjithsej u mbyllën 85 shkolla private, ndër to edhe 17 shkolla klerikale katolike¹⁶. Qeveria bëri të mundur shtimin e orëve mësimore në shqip edhe në shkollat italiane. Drejtorët e rinj që u emëruan në shkollat profesionale përfaqësonin një brez të ri që pasi kishte kryer studimet jashtë shtetit, kërkonte të ndërtonte të ardhmen në Shqipëri. Kështu në shkollën profesionale të Gjirokastrës drejtori i ri që u vendos ishte i diplomuar në Grenoble¹⁷, ndërsa në Shkodër u vendos Palok Koka, i diplomuar në Itali. Në Vlorë, drejtori i ri, Naun Stralla mbajti qëndrim të hapur kundër mësuesve italianë, duke u pakësuar orët e mësimdhëniës. Qeveria shqiptare mori edhe masa për ndalimin e dërgimit të nxënësve shqiptar në shkollat italiane.

¹³ Iljaz Gogaj, *Mirash Ivanaj, personalitet i shquar i universitetit shqiptar*, Erik botime, Tiranë, 2004, 100-108

¹⁴ Fletorja Zyrtare, 22 prill 1933, Nr 21, 2

¹⁵ Iljaz Gogaj, *Ndërhyrja arsimore*, 80

¹⁶ Paskal Milo, *Politika e jashme e Shqipërisë*, Toena, Tiranë, 2013, 825

¹⁷ AQSH, Viti 1933, F.163, D.246

Filloi një fushatë, në të cilën u përfshinë jo vetëm mësuesit, drejtorët, por madje edhe prefektët dhe policia, që i bënë thirrje familjeve shqiptare për të tërhequr fëmijët nga shkollat italiane. Sipas Legatës Italiane, në Vlorë, pati edhe “vizita” të policisë në të tilla familje, duke i kërcënuar në rast të një veprimi të kundërt. Sipas të njëjtit burim kishte një prezencë aktive të agjentëve të policisë pranë shkollës fillore italiane. Përmenden gjithashtu një numër i madh personash të shquar në qytet, të cilët për shkak të presioneve nga qeveria apo prefektura ishin detyruar të largonin fëmijët nga shkollat italiane¹⁸.

Masat e mësipërme radikale tregonin se sa seriozisht e kishte marrë ministri Ivanaj dhe mbreti Zog reformën arsimore dhe goditjen e influencës italiane. Për vitin 1934, buxheti i arsimit ishte sa një e pesta e buxhetit shtetëror (3.141.000 fr. ari). Mirash Ivanajt iu desh të bënte një luftë të ashpër në parlament me deputetët filo-italianë si Fejzi Alizoti e Mihal Kaso, të cilët mendonin se duhej frenuar arsimi, sepse Shqipëria rrezikohej nga mbiprodhimi intelektual. Në kuadrin e përpjekjeve për forcimin e arsimit kombëtar, suprimimi i shkollave të huaja u shoqërua me hapjen e shkollave të reja si instituti femëror “Nëna Mbretëreshë” dhe shkolla femërore e Korçës¹⁹. Rezultat i këtyre masave ishte pakësimi i frekuentimit të shkollave italiane nga nxënësit shqiptar. Për këtë dëshmojnë dokumentet e lëshuara nga Legata Italiane. Ndërkohë që në vitin 1932, azil infantil italian në Tiranë frekuentohej nga 22 nxënës shqiptar, tashmë kishin mbetur vetëm 8 të tillë. Një rënie drastike vihet re edhe në shkollën femërore italiane, që drejtohej nga murgeshat, nga 60 nxënësë numri ka rënë në 5-6 të tilla²⁰.

Përmes reformës, Ahmet Zogu synonte të detyronte Italinë të tërhiqet nga kërkesat për rikthimin e kredive e për bashkim doganor. Nga ana tjetër, reforma në arsim duhej të shërbente edhe për të rritur simpatinë ndaj regjimit, duke u paraqitur si mbrojtës i arsimit kombëtar kundër ndërhyrjes së huaj. Në të gjithë vendin u organizuan mitingje “spontane” bankete, e manifestime ku drejtorë shkollash, mësues e nxënës shprehnin mbështetjen për politikën e ndjekur nga qeveria, dhe optimizmin se reforma do të ishte e suksesshme. Të tilla u zhvilluan sidomos në Vlorë dhe në Elbasan, me rastin e shtetëzimit të shkollave.

Reagimi Italian. Dështimi i negociatave italo-shqiptare

¹⁸ AQSH, Viti 1933, F.163, D.248, “Il Sig. Naçi, direttore del’ufficio di dogana di Tirana ha due figlioli, che da qualche giorno non frequentano più l’asilo. Egli ha riferito alle Suore che la sua signora, mentre passeggiava con i figlioli sul boulevard Mussolini e stata avvicinata da una direttrice di una scuola albanese... e quando ha saputo che frequentavano la scuola italiana, l’ha rimproverata ed ha aggiunto che ne avrebbe riferito al ministro. La mattina sucsesiva il sig. Naçi ebbe infatti una telefonata con la quale lo si invitava a ritirare i figlioli dalla scuola italiana, pena, la sospensione dall’ufficio... Il sig. Hoxha, impiegato alla Banca Nazionale dell’Albania, una mattina si e presentato a ritirare la bambina perche un poliziotto lo ha avvertito che avrebbe riferito alle Autorita la frequenza della bambina alla nostra scuola. Il sig. Tuni, impiegato all’ospedale militare, non manda piu il bambino perche un poliziotto sorveglia l’uscita del piccolo.”

¹⁹ Iljaz Gogaj, Mirash Ivanaj, *personalitet i shquar i universit shqiptar*, Erik botime, Tiranë, 2004, 111

²⁰ AQSH, Viti 1933, F. 163, D.248, f. 3-4

Reforma arsimore, e cila “gërvishti”, siç shprehej Ugo Sola, institucionet arsimore italiane në Shqipëri, nuk mund të mos shoqërohej nga një reagim i vendosur nga ana e Italisë. Pak ditë para shpalljes së dekretligjit mbi arsimit, në një takim me parinë klerikale në Shkodër, Koh do të deklaronte se do të bënte ç’ ishte e mundur “*për të ndaluar Ministrinë e Arsimit që të realizonte qëllimet e veta*”²¹. Me 12 prill, një ditë pasi dekreti u miratua në parlament, ai u takua me mbretin Zog, duke i tërhequr vëmendjen këtij të fundit për tre çështje kryesore. Së pari, për të mos shprehur menjëherë interesit për shkollat italiane, Legata italiane shprehte shqetësimin se reforma arsimore godiste institucionet arsimore katolike, megjithë të mirat që ato i kanë sjellë vendit. Së dyti, ai i interpretoi ligjet e reja mbi arsimin, që godisnin përhapjen e kulturës italiane në Shqipëri, si “*akte jomiqësore ndaj Italisë*”. Së treti, Koh i vuri në dukje mbretit se këto masa të marra nga qeveria shqiptare do të kishin impakt të drejtpërdrejt në qëndrimin e Italisë gjatë negociatave për huanë, që ishin akoma në vazhdim²². Ndërkohë Zogu, që e kishte ndërmarë reformën kryesisht për qëllime personale (siç u shpjegua më lart, për të reaguar ndaj këkesës italiane për bashkim doganor, për ta detyruar atë të tërhiqej dhe të rifillonte dhënien e huasë financiare, si dhe për tu shfaqur në popull si reformator patriot), përgjigjej përmes deklaratës së Ministrisë së Arsimit se reforma arsimore nuk ishte kundër Italisë, se ajo kishte për qëllim “*forcimin e bashkimit kombëtar*” dhe se emërimi i drejtorëve shqiptarë në shkollat italiane nuk kishte për qëllim të cënonte veprën arsimore e teknike italiane në Shqipëri, por “*ta ndihmonte atë në mbarëvajtjen e punës*”²³.

Çdo lëshim i yni është një goditje e rëndë ndaj prestigjit të Italisë”²⁴, i raportonte Meloni, konsulli italian në Shkodër, Musolinit. Prandaj ky i fundit urdhëroi tërheqjen e materialeve dhe personelit nga shkollat italiane. Në prill 1933, Konsulli italian në Vlorë e urdhëronte drejtorin e shkollës profesionale italiane që të dërgonte të gjitha materialet mësimore e teknike në Shkodër²⁵, ku prej aty do të dërgoheshin më pas në Romë. Kudo ku Ministria e Arsimit emëroi drejtorë shqiptarë, shkollat italiane në shenjë proteste u mbyllën. Rasti më flagrant ndodhi në Shkodër, ku konsullata italiane i dha urdhër bordit drejtues të shkollës profesionale, që në momentin kur drejtori shqiptar i caktuar nga Ministria e Arsimit të prezantohej, shkolla të mbyllej menjëherë.

Demontrata navale italiane dhe abrogimi i reformës arsimore

²¹ Iljaz Gogaj, *Ndërrhyrja arsimore italiane në Shqipëri dhe qëndresa kundër saj*, 8 Nëntori, Tiranë, 1980, 44

²² Po aty, 47

²³ Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e mbretit Zogu I*, Ermir, Tiranë, 1997, 244

²⁴ AQSH, Viti 1933, Fondi 163, Dosja 265, fl. 5

²⁵ AQSH, Viti 1933, Fondi 163, Dosja 264, fl. 10

Por në muajt e mëvonshëm vështirësitë e brendshme e detyruan Zogun të bënte një tërheqje graduale nga të gjitha pozicionet e mëparshme. Kriza në marrëdhëniet italo-shqiptare arriti kulmin. Musolini vendosi të reagoonte ndaj kundërshtimeve të Shqipërisë për të arritur një marrëveshje për kushte të reja italiane për huanë, Duçja u alarmua edhe më tepër nga përpjekjet e Ahmet Zogut për tu afruar me Francën dhe Jugosllavinë. Me 23 qershor 1934, 22 anije italiane u ankoruan përballë frontit të Durrësit. Bllokada navale italiane dhe moreagimi i Francës dhe Anglisë e bindi mbretin e Shqipërisë se nuk kishte rrugë tjetër përveç rikthimit tek Italia²⁶. Ndërkohë, gjendja ekonomike e vendit, me tërheqjen e huave italiane shkoi gjithnjë e më shumë drejt degradimit. Gjithashtu, mbyllja e shkollave italiane ishte shoqëruar edhe me mbylljen e shkollave katolike në Shkodër dhe atyre greke në jug të vendit. Kjo u shoqërua me protesta në Shkodër dhe rritjen e pakënaqësisë së klerit katolik, që kishte një influencë të madhe në Veri, ndërkohë që pala greke e çoi çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Hagës.

Kwshtu, Ahmet Zogu nw bisedimet qw filluan menjwherw nw muajt qw asuan demonstratwn navale italiane, pranoi ndwr tw tjera edhe arritjen e një kompromisi për çështjen e shkollave katolike e italiane, rihapjen e tyre dhe heqjen dorë nga monopoli shtetëror mbi arsimin²⁷. Këtu ndikuan edhe presionet e bëra nga Lidhja e Kombeve, për shkak të mbylljes së shkollave të minoritetit grek. Në gusht 1935, edhe ministri Ivanaj paraqiti dorëheqjen: *“tue qenë i bindun se vetëm në shkollat e shtetit, pa as më të voglin cënim të të drejtave individuale osë kolektive, djelmënia jonë mund të edukohet si e tillë e të fitojë ndjesinë dhe ndërgjegjen kombëtare, moralin dhe disiplinën shtetërore, nuk mund të bashkohem me mendimin e shumicës së Këshillit Ministror. Për këtë arsye, kam nderin të paraqes dorëheqjen nga dikasteri i arsimit”*²⁸. Më në fund edhe ai e kuptoi se reforma arsimore nuk kishte pasur për qëllim zgjidhjen e problemeve arsimore në vend, por thjesht ishte përdorur si një mjet për të bërë presion ndaj Italisë.

Në vendimin përfundimtar të Zogut për tu rikthyer nën ombrellën italiane ndikoi edhe fakti se nuk u arrit të gjendej një tjetër shtet që mund t’i ofronte Shqipërisë ndihma dhe kredi financiare. Rikthimi i plotë nën ombrellën italiane u realizua në marrëveshjet e marsit 1936 që përmbanin klauzolat për dhënien e kredive italiane për rimëkëmbjen ekonomike të vendit, por gjithnjë në këmbim të koncesioneve për shoqëritë monopoliste italiane dhe rritjen e ndikimit Italian në sektorët e administratës dhe ushtrisë shqiptare²⁹.

²⁶ Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Çabej, Tiranë, 2004, 229

²⁷ Po aty, 239

²⁸ Iljaz Gogaj, *Mirash ivanaj personalitet i shquar i universit shqiptar*, Erik botime, Tiranë, 2004, 180-181

²⁹ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Toena, Tiranë, 2009, 545-546

Por Ahmet Zogu nuk pranoi që një klauzolë mbi arsimin të përfshihej në marrëveshjet e marsit 1936, për dy arsye: së pari, të mos krijohesh përshtypja para opinioinit publik se shkollat katolike e italiane po hapeshin nën presionin e Italisë dhe së dyti, donte ta zvarriste sa më shumë çështjen në mënyrë që t'i tërhiqte sa më shumë të holla italianëve. Rihapja e shkollave katolike dhe të huaja u shpall zyrtarisht nga ministri i jashtëm Fuat Asllani. Me 8 maj 1936, ai paraqiti në Gjenevë, në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve deklaratën e qeverisë për shkollat klerikale. Ndërkohë, u publikua në Fletoren Zyrtare dokumenti që lejonte funksionimin e lirë të shkollave të klerit katolik dhe të çdo shkolle tjetër që do të kishte autorizimin e Ministrisë së Arsimit³⁰. Dekreti hidhte poshtë ligjin e 11 prillit 1933.

Përfundime

Reforma Arsimore për nacionalizimin e arsimit në Shqipëri u ndërmor në radhë të parë për t'i shërbyer kursit të ri të politikës së jashtme të ndjekur nga mbreti Ahmet Zogu dhe qeveria shqiptare. Duke filluar nga viti 1931 mbreti shqiptar kishte vendosur t'i kundërvihesh përpjekjeve të Italisë fashiste për të rritur ndikimin e saj politik e ekonomik në vend, duke refuzuar rinovimin e Traktatit të Miqësisë dhe Sigurimit. Benito Musolini u kundërpërgjigj duke tërhequr të gjitha ndihmat financiare për Shqipërinë, duke e çuar në rritjen e vështirësive ekonomike në vend. Pikërisht në këtë sferë politik duhet parë iniciativa e Ahmet Zogut dhe qeverisë shqiptare për të goditur drejtpërdrejtë prestigjin që gëzonte Italia në vend, duke ndërmarrë nacionalizimin e arsimit, shtetëzimin e shkollave italiane. Së dyti kjo masë i përgjigjej edhe aspiratave politike të qarqeve patriotike e nacionaliste brenda vendit, që e panë këtë si një masë të mëtijshme në procesin e nacionalizimi dhe laicizimit të arsimit. Nën drejtimin e ministrit të arsimit Mirash Ivanaj, reforma mori karakter të mirëfilltë kombëtarist, duke realizuar unifikimin e organizimit dhe programeve në shkollat shqiptare. Por reforma nuk u ndal vetëm në nacionalizimin e shkollave italiane, por u shtri edhe më gjerë në mbylljen e të gjithë shkollave të huaja (amerikane, franceze) dhe klerikale, duke shkaktuar ndër të tjera edhe pakënaqësi në disa sektorë shoqëror, por edhe tension diplomatik në rastin e mbylljes së shkollave greke në jug të vendit. Pikërisht duke iu përgjigjur këtyre vështirësive të krijuara, por sidomos nga presioni i faktorit të jashtëm, që arriti kulmin me demonstratën navale italiane, qeveria shqiptare u detyrua të tërhiqej, të rikthehej nën ombrellën italiane dhe të nxjerrte një dekret të ri mbi arsimin për rihapjen e shkollave. Pavarësisht kohës së shkurtër të zbatimit të saj, reforma arsimore e drejtuar nga Mirash Ivanaj pati rëndësinë e saj në disa aspekte. Reforma filloi realizimin e një procesi që kishte karakterizuar ndërtimin e shtet-kombit në shumë vende

³⁰ Iljaz Gogaj, *Ndërrhyrja arsimore italiane në Shqipëri dhe qëndresa kundër saj*, 8 Nëntori, Tiranë, 1980, 56-57

të Evropës. Reformat për nacionalizimin, laicizimin dhe unifikimin e arsimit kombëtar në fazat e parë të ngritjes së shtetit-komb, shikoheshin si element i rëndësishëm në ngritjen e identitetit kombëtar në masat e gjera të popullsisë. “Ndeshja me Italinë siguroi një vatër, edhe pse gjithsesi negative, për rritjen dhe forcimin e ndjenjave nacionaliste”³¹. Nga ana tjetër, reforma arsimore dhe karakteri i saj me drejtim anti-italian demostroi vullnetin e mbetit Zog dhe qeverisë shqiptare për t’i rezistuar synimeve imperialiste e kolonialiste të Italisë fashiste dhe Benito Musolinit ndaj Shqipërisë. Sigurisht, duke mos gjetur mbështetjen e duhur ndërkombëtare dhe duke parë rëndimin e vazhdueshëm të gjendjes ekonomike të vendit në vitet që pasuan, qeveria shqiptare u detyrua të tërhiqej nga kjo politikë dhe të pranonte rikthimin e ndikimit Italian e për rrjedhojë edhe abrogimin e reformës arsimore.

³¹ Bernd J. Fischer, *Diktatorët e Ballkanit*, AiiS, Tiranë, 2009, 54

Bibliografia

Iljaz Gogaj, *Ndërhyrja arsimore italiane në Shqipëri dhe qëndresa kundër saj*, Tiranë, 8 Nëntori, 1980.

Iljaz Gogaj, *Mirash Ivanaj personalitet i shquar i universit shqiptar*, Tiranë, Erik botime, 2004.

Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e mbretit Zogu I*, Tiranë, Ermir, 1997.

Paskal Milo, *Politika e jashme e Shqipërisë I (1912-1939)*, Toena, Tiranë, 2013.

Erik Hobsbaum, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780-a*, Toena, Tiranë, 1996.

Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Çabej, Tiranë, 2004.

Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Toena, Tiranë, 2009.

Bernd J. Fischer, *Diktatorët e Ballkanit*, AiiS, Tiranë, 2009.

Burime arkivore/shtypi

AQSH, Viti 1933, F.163, D.246

AQSH, Viti 1933, F.163, D.248

AQSH, Viti 1933, Fondi 163, Dosja 265

AQSH, Viti 1933, Fondi 163, Dosja 264

Fletorja Zyrtare, 22 prill 1933, Nr 21

Gazeta e Re, dt. 8.1.1929, Nr.55